



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
QENDRA BALNEARE "ENVER SHEHU" PESHKOPI

PROJEKT - VENDIM

Nr. 02 datë 08/05/2024

" PËR NJË NDRYSHIM NË TARI FAT E QENDRËS BALNEARE "ENVER SHEHU" PESHKOPI TË MIRATUARA NË PAKETËN FISKALE TË BASHKISË DIBËR PËR VITIN 2024

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës ___/___/2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.1/b, si dhe neni 64 "Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë" ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligji nr.687/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2024 me vendimin nr.129 datë 12.12.2023 me konfirmim të institucionit të Prefektit Qarkut Dibër nr.1238/1 datë 21.12.2023:

Kërkojmë:


1. Miratimin e ndryshimeve të tarifave për Qendrën Balneare "Enver Shehu" Peshkopi si më poshtë:

- Tarifa për klientët që akomodohen në hotelin e Qendrës Balneare "Enver Shehu" Peshkopi (fjetjes në hotel, ushqimi me 3 vakte dhe 2 herë larje banje në ditë) të jetë në vlerën 2.000 lekë në ditë.
- Tarifa për klientët që marrin shërbimin e terapisë së baltës të jetë në vlerën 800 lekë për seancë.
- Tarifa për klientët që marrin shërbimin e fizioterapisë të jetë në vlerën 800 lekë për seancë.
- Tarifa për parkim Brenda ambjentëve të Qendrës Balneare "Enver Shehu" Peshkopi 100 lekë për dy ore parkim, 200 leke mbi dy ore parkim.
- Tarifa për larjen në pishinë të jetë në vlerën 400 lekë për larje.
- Kuota ushqimore për çdo klient që frekuenton hotelin e Qendrës Balneare "Enver Shehu" Peshkopi të jetë në vlerën 700 lekë në ditë.
- Larja Ambulatore (vaskë) për qytetarët dëbnanë me biletë 150 lekë për larje.


- Tarifa e larjes (vaskë) për çdo klientë të shtruar në Hotel Privat do të jetë 250 lekë larje, ku nga kjo tarifë 25 lekë l përket taksës së fjetjes në hotel, tarifë e bashkisë e cila do të mbahet klientit për shërbimin.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra Balneare "Enver Shehu" Peshkopi dhe Drejtoria Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:


Përgjegjës Financë Qendra Balneare
Mensur Shehi




Drejtor Qendra Balneare
Endri Çenga



Drejtor Taksave dhe Tarifave Vendore
Lorenc Cibaku



Drejtor Juridik
Ismet Saraci



KRYETARI I BASHKISË
Rahim Spahiu

Në mungesë dhe me porosi

Zhv. Kryetar
Ruzhdi Dedu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
QENDRA BALNEARE 'ENVER SHEHU' PESHKOPI

Nr. 08/1 Prot

Peshkopi, më 08.05.2024

Lënda : Relacion mbi një ndryshim në paketën Fiskale për vitin 2024 për Qendren Balneare Peshkopi.

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK D I B Ë R

Të nderuar këshilltarë!

Ky propozim për ndryshim të tarifave për vitin 2024 për shërbimet që ofron Qendra Balneare vjen si rezultat i mosbalancës të theksuar midis të ardhurave që arketohen dhe kostos për ofrimin e këtij shërbimi. Në koncept tarifa është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik kryen në këmbim të një shërbimi specifik të marrë nga njësisia e vetëqëverisjes vendore. Parimi është që niveli i tarifës duhet të orientohet drejt mbulimit të kostos së shërbimit të ofruar.

Në këtë Qendër funksionojnë një sërë kabinetesh si: Hidroterapia (larje në vaska me dy seksione), Fangoterapia (terapi me baltë), Pishina (përdoret kur terapia shoqërohet me gjimnastikën ose levizje aktive në ujë) si dhe Hotelcri + Guzhinë. Vite më parë janë ofruar shërbime të tjera të cilat aktualisht nuk funksionojnë për mungesë ambientesh, personeli dhe pajisjesh si fizioterapija (shërbim që synojmë ta vëmë në funksion në vazhdimësi).

Thënë më sipër ne si staf kemi vërejtur se disa nga tarifat që qendra jonë përdor aktualisht nuk mbulojnë kostot, objektivi ynë kryesor është të rrisim cilësinë e shërbimit dhe që Qendra Balneare Peshkopi të balancojë të ardhurat me shpenzimet.

Duke qenë se kostot për të gjitha zerat e shpenzimeve (mallra ushqimore, materiale pastrimi, shërbimet mirëmbajtëse, pagat e personelit etj) janë rritur në masë të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme, nderkohe që tarifat e shërbimeve janë të njëjta me periudhën kur Qendra Balneare Peshkopi ushtronte funksionin me vendimarrje të Këshillit Drejtues kërkojmë sipas propozimeve të Këshilltarëve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Ndryshim në paktin Fiskal të vitit 2024 për tarifën :

- Tarifa për klientet që akomodohen në hotelin e Qendres Balneare Peshkopi (fjetjes në hotel, ushqimi tre vakte dhe dy here banje) të jetë 2.000 leke në ditë
- Aktualisht kjo tarifë është 1.500 leke në ditë, e njëjta me nivelin kur Qendra Balneare Peshkopi ka funksionuar me Këshill Drejtues.


- Tarifa per klientet qe marrin shërbimin e terapise se baltes te jete 800 leke per séance e njejte me tarifen qe ka qene kur Qendra Balneare ka funksionuar me Keshill Drejtues.
- Tarifa për klientët që marrin shërbimin e fizioterapisë të jetë në vlerën 800 lekë për séance.
- Tarifa për parkim Brenda ambjenteve të Qendrës Balneare "Enver Shehu" Peshkopi 100 lekë 0-2 ore parkim, 200 leke mbi 2 ore parkim.
- Tarifa per larje në pishinë te jete 400 Lekë per klient.
- Kuota ushqimore te jete 700 leke ne dite.
- Larja Ambulatore (vaskë) për qytetarët dibranë me biletë 150 lekë për larje.
- Tarifa e larjes (vaskë) për cdo klientë të shtruar në Hotel Privat do të jetë 250 lekë larje, ku nga kjo tarifë 25 lekë i përket taksës së fjetjes në hotel, tarifë e bashkisë e cila do ti mbahet klientit për shërbimin.

Tarifat e mesiperme jane te ulte ne krahasim me çmimet aktuale te tregut, por propozimi per keto tarifa eshte bazuar ne gjendjen ekonomike te klienteve qe frekuentojne Qendren Balneare Peshkopi pasi pjesa me e madhe jane pensioniste dhe ne gjendje shendetesore jo te mire si dhe konkurrencen e operatoreve ekonomik privat qe e ofrojne keto shërbim.

Bashkengjitur relacionit tabela mbi llogaritjen e kuotes ushqimore per nje dite.

Me respekt:

P/Finances
Mensur SHEHI



DREJTORI
Endri Çenga



Perflogaritja e kuotes ushqimore ditore per Qendren Balneare Peshkopi

Miratol
Drejtori
Endri Çelina



Nr.	Pershkrimi i mallit	Njesia e matjes	sasia ditore	Cmimi	Vlera
1	Veze	kokor	1	15	15
2	Makarona	kg	0.15	139.2	20.88
3	Miell	kg	0.03	90	2.7
4	Vaj	liter	0.04	200.4	8
5	Vaj ulliri	liter	0.02	252	5.04
6	Jeng limoni	liter	0.05	168	8.4
7	Salce shishe	kg	0.05	100.8	5.04
8	Kripe e jodizuar	kg	0.005	33.6	0.168
9	Amita 200 ml	cope	1	26	26
10	Sheqer	kg	0.03	120	3.6
11	Domate	kg	0.18	192	34.56
12	Tranguj	kg	0.06	192	11.52
13	Patate	kg	0.22	108	23.76
14	Speca	kg	0.22	192	42.24
15	Depe e thate	kg	0.04	114	4.26
16	Fasule	kg	0.05	276	13.8
17	Banane	kg	0.3	234	46.8
18	Qumesht	liter	0.5	123.4	61.716
19	Djathe lope	kg	0.05	600	30
20	Gjalp	kg	0.06	600	36
21	Mish vici	kg	0.2	1200	240
22	Buke gruri	kg	0.5	119	60.5
	Shuma				700

K/Kuzhiniere
Shpresa Xhika

P/Finances
Mensur SHEHI